

NEWSLETTER

ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË

Gjatë muajit korrik Bordi i ERE-s ka zhvilluar 7 mbledhje, që kanë rezultuar në 24 vendimmarrje, ndër të cilat:

Licencimin e shoqërive:

1. "GreeNNat Solar Park Ballsh" shpk, në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaiik, me kapacitet prodhues 100 MW, dhe vendndodhje në Bashkinë Mallakastër, për një afat 25-vjeçar duke filluar nga data 01.06.2028.
2. "5GX ENERGY" shpk në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaiik me kapacitet të instaluar 10 MW, me vendndodhje në Qarkun Fier, për një afat 30-vjeçar, duke filluar ky afat nga data 01.08.2024, me kusht që shoqëria të depozitojë në ERE amendimin e kontratës së nënshkruar me MIE.
3. "AGE ERZEN" shpk në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC "Hekali", me kapacitet të instaluar 1940 kW, me vendndodhje në pellgun ujëmbledhës të lumit Erzen, Bashkia Tiranë, për një afat 30-vjeçar, duke filluar nga data 01.06.2026, me kushtin që shoqëria të depozitojë në ERE lejen e rinovuar të përdorimit të burimit ujor brenda datës 18.09.2025.
4. "H.K. HEC GRABOVA 2" shpk në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC Grabova 2, me kapacitet total të instaluar 10.8 MW, me vendndodhje në pellgun e përroit të Grabovës, Gramsh, Qarku Elbasan, duke filluar ky afat nga data 24.10.2024 deri në 14.09.2052, me kushtin që shoqëria të depozitojë në ERE qëndrimin e Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë dhe/ose amendimin e kontratës së nënshkruar, për kërkesën e bërë nga ana e saj mbi zgjatjen e afatit të datës së fillimit të operimit të hidrocentralit "Grabova 2".

Në këtë gazetë do të lexoni mbi

Licencime të muajit në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike

Fillime të procedurave për licencim

Akte Rregullatore

Tarifa dhe çmime

Autorizime dhe akte të tjera

Aktivitete

Seanca dëgjimore dhe konsultime

NEWSLETTER

ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË

Fillimin e procedurës për licencimin e shoqërive:

- “ACHELO” shpk në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC “KOTORRI” me kapacitet prodhues 1.9 MW dhe vendndodhje në Qarkun Elbasan, vendimmarrja për të cilën u shty me 30 ditë nga data 31.07.2024, si rezultat i nevojës për saktësime nga ana e shoqërisë.
 - “BMG ENERGY SAL” shpk në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik, me kapacitet prodhues 2 MW, me vendndodhje në Qarkun Fier.
 - “SUN’S MIRACLE” shpk në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik me kapacitet të instaluar 2MW, me vendndodhje në Qarkun Fier.
 - “Albania Power Core” shpk në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik me kapacitet prodhues 40.56 MW dhe veprave ndihmëse, në Qarkun Fier.
1. Fillimin e procedurës për rinovimin e licencës së shoqërisë FURNIZUESI I SHËRBIMIT UNIVERSAL” sha në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike, dhënë me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 97, datë 27.10.2014, rinovuar me vendimin nr. 164, datë 04.11.2019, për një afat 5-vjeçar, duke filluar nga data 21.12.2024.
 2. Rinovimin e licencës së shoqërisë “KROI MBRET ENERGJI” shpk, në veprimtarinë e tregimit të energjisë elektrike, dhënë me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 192, datë 02.12.20219, për një afat 5 vjeçar, duke filluar nga data 03.12.2024.
 3. Zgjatjen deri në 30 (tridhjetë) ditë të afatit të vendimmarrjes së Bordit të ERE-s për kërkesat e shoqërive “Nova Prospect” shpk dhe “FAETHON” shpk për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, duke i dhënë kohë të depozitojnë në ERE dokumentacionin e munguar gjatë aplikimit apo dhe çdo saktësimi/korrespondence të nevojshme, brenda 20 (njëzet) ditëve.
 4. Një ndryshim në vendimin e Bordit të ERE-s nr.254, datë 23.08.2023, “Mbi licencimin e shoqërisë “G.S.K” sh.p.k në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik me kapacitet të instaluar 2MW, duke vendosur kushtin që shoqëria të depozitojë në ERE një VNM të rinovuar përpara fillimit të operimit/ushtrimit të veprimtarisë së energjisë elektrike

Akte Rregullatore

- Miratimin e “Kushteve të përgjithshme të Kontratës TIP për Mbështetje” përfshirë kushtet e Përgjithshme të CFD të cilat bëhen të zbatueshme pas miratimit sipas Modelit të Tregut të energjisë elektrike.
- Miratimin e pjesshëm të kërkesës së OSSH sh.a., për disa shtesa dhe ndryshime në “Rregulloren për lidhjet e reja në sistemin e shpërndarjes”, miratuar me vendimin nr.166, datë 10.10.2016, të bordit të ERE, të ndryshuar. Miratimi i rregullores do të mundësojë thjeshtimin e procesit të aplikimit për lidhjet e reja në sistemin e shpërndarjes duke mundësuar po ashtu dhe aplikimin online në fazën e parë për konsumatorët të lidhur në tension të ulët dhe në një fazë të mëvonshme për të gjithë konsumatorët. Po ashtu këto ndryshime kanë marrë në konsideratë dhe problematikat e hasura deri me tani nga ana e OSSH sh.a. apo dhe konsumatorëve gjatë procesit të aplikimit dhe miratimit të lidhjeve të reja. Për tu njohur me ndryshimet specifike, ju lutemi të shfletoni faqen tonë zyrtare në kategorinë vendime.
- Zgjatjen e efekteve juridike të vendimit të Bordit të ERE-s nr.51, datë 02.04.2024, deri më 01.03.2025, duke i krijuar mundësinë OST sh.a. dhe pjestarëve të tregut të balancimit të bëjnë vlerësimet dhe ndërhyrjet përkatëse për sa është e mundur për kalimin në rezolucionin 15 minutësh në të ardhmen.

NEWSLETTER

ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË

Tarifa dhe çmime

Miratimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike të furnizuar nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit për muajin qershor 2024 prej 14.65 Lekë/kWh për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 35 kV.

Autorizime dhe akte të tjera

Pranimin e kërkesës së shoqërisë "Egnatia Hydropower" shpk për dhënien e autorizimit të ERE-s për vendosjen e kuotave të saj si mjet për të garantuar përmbushjen e detyrimit ndaj palës kredidhënëse, "RAIFFEISEN BANK" sha, me kusht që shoqëria të njoftojë menjëherë ERE-n për heqjen e barrës siguroese mbi kuotat ose në rast të ndodhjes së një ekzekutimi të detyrueshëm.

Dhënien e Garancisë së Origjinës për prodhimin e energjisë elektrike nga hidrocentralet "Dragobia" dhe HEC "Çeremi" të shoqërisë "DRAGOBIA ENERGY", për sasinë prej 947 MWh periudhën 01.11.2022 – 30.10.2023, sasi energjie e cila nuk përfiton nga masat mbështetëse në përputhje me ligjin 24/2023 "Për nxitjen e prodhimit të enegjisë nga burimet e rinovueshme"; si dhe për energjinë elektrike të prodhuar nga parku fotovoltaik "Blue 1", i shoqërisë "SPV BLUE 1" shpk, gjatë periudhës 01-30 qershor 2024, për sasinë 10 657 MWh, e vlefshme për 1 (një) vit nga data 30 qershor 2024.

Ndryshimin e pikës 2 në vendimin e Bordit të ERE-s nr. 15, datë 31.01.2019, "Mbi licencimin në aktivitetin e transmetimit të gazit natyror të TRANS ADRIATIC PIPELINE AG ALBANIA, e regjistruar pranë QKB si degë e shoqërisë së huaj aksionare (SHA) TRANS ADRIATIC PIPELINE AG", i ndryshuar, sipas të cilës shoqëria duhet të paraqesë në ERE dokumentacionin e plotë që tregon titujt e pronësisë mbi asetet që ka për të kryer funksionet ose plotësuar detyrimet nën licencën e kërkuar në territorin e Shqipërisë, sipas ligjit nr. 107/2021 "Për bashkëqeverisjen", jo më vonë se data 01.07.2026.

Për tu njohur me këto vendime dhe të tjera, në mënyrë më të detajuar, ju ftojmë të vizitoni faqen tonë zyrtare www.ere.gov.al në kategorinë [vendime](#).

NEWSLETTER

ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË

Transparenca

Sipas Raportit të indeksit të transparencës proaktive të institucioneve qendrore dhe të varësisë, të publikuar në webfaqen e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, Enti Rregullator i Energjisë rreshtohet ndër insitucionet me transparencë proaktive të lartë, ku të gjitha informacionet rezultojnë të publikuara dhe duke grumbulluar 10/10 pikë të mundshme. Raportin mund ta shfletoni në linkun [këtu](#).

Seanca dëgjimore

Pjesë e aktivitetit të ERE-s kanë qënë dhe 4 seanca dëgjimore të zhvilluara për zgjidhjen e ankesave dhe marrjen e qëndrimeve të palëve, si dhe me subjekte të licencuara, me qëllim sqarimin e paqartësive dhe për të rezultuar me një vendimmarrje më të plotë.

Strategjia ndërsektoriale MEKI

Një nga objektivat kryesorë të ERE-s është mbrojtja e interesave të konsumatorëve, dhe në këtë strategji ndër arritjet më efektprurëse për këtë qëllim gjatë këtij 5 vjeçari, kanë qënë miratimi nga ERE i një sërë aktesh që lidhen ngushtë me realizimin e shërbimit me standard nga ana e licencuarve. Gjatë viteve 2017-2021 janë miratuar mbi 90 akte nënligjore në zbatim të ligjit të energjisë elektrike dhe atij të gazit natyror, 80% e të cilave lidhen me rregullim të sektorit me impakt të drejtëpërdrejtë tek konsumatori.

Një ndër objektivat e kësaj strategjie lidhet me përmirësimin e aksesit në të dhëna të konsumatorit të energjisë dhe Platformës së konsumatorit në faqen web të ERE, siç janë zhvillimi i Portalit të Konsumatorit; plani për ndërgjegjësimin e konsumatorit i cili përfshin një politikë të pjesëmarrjes së konsumatorit apo dhe udhëzime të përmbledhura mbi të drejtat dhe detyrimet që lidhen me shërbimet e ofruara nga të licencuarit. Pjesë e rëndësishme e mekanizmave që sigurojnë pjesëmarrjen në informacion të konsumatorëve janë edhe investimet në teknologjinë e informacionit me vlerësimin e kujdesëshëm të kostove të lidhura me investimet në sektor, siç është dhe ngritja e një platforme të integruar me furnizuesit në të cilën çdo konsumator do të ketë akses më shumë, për sa i takon shërbimit të furnizimit me energji duke përfshirë historikun e konsumit, të dhëna teknike etj. Kjo platformë është në proces përmirësimi nga ana e Entit Rregullator të Energjisë.

NEWSLETTER

ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË

USAID - NARUC

Europe & Eurasia Iniciativa Cybersecurity

Në data 8 dhe 9 korrik NARUC organizoi në Tiranë "Trajnimin teknik për hartimin e legjislacionit për gatishmërinë emergjente për rregullatorët e energjisë", me suport të USAID. Qëllimi parësor i këtij aktiviteti ishte diskutimi i përbashkët i draftimit të një rregulloreje për gatishmërinë emergjente për sektorin e energjisë elektrike. NARUC dhe ekspertët e saj vullnetarë, ndanë përvojën e tyre me pjesëmarrësit. Gjatë diskutimeve dolën në pah përpjekjet dhe sfidat e vendeve pjesmarrëse në transpozimin e Paketës së Integritit të Energjisë Elektrike, duke i nxitur këto të fundit që ta përfundojnë deri në fund të vitit 2024 procesin e bashkimit të tregjeve. U theksua gjithashtu, nevoja për ekspertizë dhe burime, zhvillim të infrastrukturës për dekarbonizim dhe mbështetje financiare për kalimin në hidrogjen, si dhe u vu në dukje rëndësia e emërimeve të NEMO-ve, aktiviteteve të CCR-së dhe investimeve në energji të rinovueshme.

Të tjera

Duke shfletuar faqen tonë zyrtare www.ere.gov.al, mund të njiheni me të dhënat e fundit të [tregut të energjisë në vend](#), [regjistrat e licencimit të subjekteve](#), [të garancive të origjinës](#) dhe të [ankesave](#) të rifreskuar, si dhe [tarifa dhe çmime](#) të miratuara nga ERE.

Në zërin [konsultime](#), ju ftojmë gjithashtu të lexoni materialin e mëposhtëm mbi të cilin mund të dërgoni opinionin tuaj si palë interesi, në adresën tonë të e-mailit erealb@ere.gov.al:

- [Kontratë Tip për Depozitimin, Shkëmbimin, Shitjen, Blerjen e Energjisë Elektrike midis shoqërive "KESH" sh.a. dhe "FTL" sh.a.](#)

